



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:129332

Datë: 02.03.2022

Numri i dokumentit: 02771978

CPK.nr. 99/21

P.nr.783/15

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Venhar Salihu, duke vendosur në procedurën përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizimin me Energji Elektrike (KESco), Rr. “Dëshmorët e Kombit”, Gjilan, të cilën me autorizim e përfaqëson A. R, jurist nga Prishtina kundër debitorit S.A, nga fsh. ..., Komuna e Gjilanit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, jashtë seancës gjyqësore më datën 02.03.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZHET si i pa bazuar prapësimi i datës 08.01.2016, i debitorit S. A i paraqitur kundër Urdhërit Përmbartimor P.nr.783/15, të datës 23.10.2015, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa për teritorin e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe urdhëri i lartcekur **mbetet në fuqi** vetëm sa i përket shumës prej 1,374.73, për përuhdën prej 04.01.2014 e deri me 17.11.2015.

II. Në raste të paraqitjes të ankesës kundër këtij aktvendimi **OBLIGOHET** debitori S.A që të deponoj shumën e të hollave në lartësi prej 130€, në emër të garancisë. Nëse pala ankuese dështon ta paguajë shumën e garancisë të caktuar nga gjykata, ankesa konsiderohet se nuk është dorëzuar fare në gjykatë.

A r s y e t i m i

Përmbartuesi Privat ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor të propozuar nga kreditori, Kompania Kosovare per Furnizim me Energji Elektrike sha, kunder debitorit S. Ai nga fsh. ...,

K.Gjilan, lidhur me përmbarrimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit, në shumë të përgjithshme prej 1,858.69€.

Debitori, pas pranimit të urdhrit përmbarrimor, në afat ligjor më datën 08.01.2016, ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se në propozimin për përmbarrim, pjesa më e madhe e detyrimit që parashihet aty, është parashkruar, përkatësisht borxhi i krijuar për periudhën prej vitit 2013 deri në janar të vitit 2015, pasi që ka kaluar më tepër se një vit nga viti 2013. Sa i përket pjesës së borxhit që nuk është parashkruar, i njëjti ka kërkuar ndalimin e përmbarrimit duke u bazuar në nenin 85 të LPP-së, pasi që i njëjti është veteran dhe ka probleme shëndetësor si

pasojë e plagëve të marra gjatë luftës. Andaj nga gjykata ka kërkuar që urdhri përmbarrimor të anulohet si i pabazuar.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të dt. 21.01.2016, i ka kundërshtuar pjesërisht pretendimet e debitorit të theksuara në prapësim si të pabazuara ngase ka konsideruar se borxhi i krijuar nga debitori nga janari i vitit 2014 e tutje deri në ditën e ushtrimit të propozimit nuk është parashkruar, dhe në borxhin e llogaritur është marrë parasysh që i njëjti është përfutues i ndihmës sociale. Gjithashtu, kreditori ka bërë zvoglimin e vlerës së borxhit të kërkuar nga shuma 1,858.69€, në shumën 1,374.73€ për periudhën nga dt.04.01.2014 deri më dt.17.11.2015. Për këto arsye, gjykatës i propozoj që prapësimi i debitorit të refuzohet si i pabazuar dhe urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, duke vepruar në bazë të rekomandimeve të Gjykatës së Apelit, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore më dt. 15.09.2021.

Kreditori, përkatësisht i autorizuari i tij, në seancën dëgjimore, ka mbetur në tërësi pranë propozimit për përmbarrim dhe ndryshimit të bërë në përgjigjen në prapësim, duke kërkuar që debitori të paguajë në emër të borxhit, shumën prej 1,374.73€ për periudhën kohore nga dt. 04.01.2014-17.11.2015 për shkak të shpenzimit të energjisë elektrike, për të cilën nuk ka paguar faturat mujore. Sipas kreditorit, kërkesa e tyre nuk është parashkruar ngase borxhi kërkohet për periudhën janar 2014 e deri në nëntor të vitit 2015, kurse në anën tjetër propozimi për përmbarrim është dorëzuar në vitin 2015 dhe se bazuar në nenin 360.2 të LMD-së, kërkesa jonë nuk është parashkruar, por është paraqitur brenda afatit ligjor.

Debitori, në seancën dëgjimore, ka pohuar faktin se i njëjti ka shfrytëzuar energjinë elektrike gjatë vitit 2014 dhe 2015, por për shfrytëzimin e të njëjtës nuk ka paguar. Arsyeja e mos pagesës qëndron në faktin se i njëjti është invalid i luftës dhe se pensioni i tij është 150.00€, kurse ai jeton në bashkësi familjare me 6 anëtarë, të cilët nuk punojnë.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palëve vërtetoi se prapësimi i debitorit është i pabazuar, pasi që me këtë prapsim nuk ka vërtetuar asnjërin nga shkaqet të cilat janë paraparë në nenin 71 të LPP-së lidhur me bazueshmërinë e prapësimit dhe se faturat e bashkangjitura në përgjigje në prapësim të kreditorit, paraqesin titull përmbarrimor–dokument të besueshëm, duke u bazuar në nenin 29 të LPP-së, kurse sa i përket shumës, urdhëri përmbarrimor mbetet për shumën prej 1374.73€, për periudhën nga 04.01.2014 e deri më 17.11.2015. Prandaj për këto arsye u vendos si në pikën I të dispozitivit.

Gjykata analizoi edhe pretendimin se në rastin konkret kemi parashkrim të kërkesës, ky pretendim nuk qëndron për shkak se debitori ka paguar kohë pasë kohe shuma të caktuara për shpenzimin e energjisë elektrike (ky fakt është vërtetuar në bazë të transaksionit të konsumatorit) si dhe për faktin se kreditori kërkon me këtë propozim borxhin nga periudha 04.01.2014 deri më 17.11.2015, kurse propozimi për përmbarrim ka paraqitur me datë 22.12.2015 në bazë të nenit 360.2 të LMD-së nuk ka parashkrim, kurse pretendimet tjera nuk

janë relevante në këtë procedurë. prandaj bazuar në nenin 368 të LMD-së, pagesa e shumave të caktuara nga ana e debitorit, ndërprejnë parashkrimin.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 78 pika 1 dhe 2, që debitori të paguajë shumën prej 50.00€, nëse eventualisht paraqet ankesë. Sa i përket shumës së caktuar, gjykata është e mendimit se shuma e caktuar është në interesin e të dy palëve, edhe për kundër se pika 2 e dispozitës së lartcekur, ka paraparë të caktohet shuma e plotë e kredisë, e që në rastin konkret është dashur të caktohet shuma prej 1374.73€, por në bazë të standardit jetësor në vendin tonë, një shumë e tillë mundë të jetë shumë e lartë, gjithashtu bazuar edhe në kushtet ekonomike të debitorit, kjo gjykatë është e mendimit se shuma prej 130€ është shumë e arsyeshme dhe u llogarit 10% i shumës së përgjithshme, d.m.th. shuma prej 130€.

Nga të cekurat më lart e në pajtim me nenin 5, 29, 71 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në pikën I dhe II të këtij aktvendimi.

**Gjyqtari,
Venhar Salihu**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, brenda 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.